



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:187302

Datë: 15.02.2021

Numri i dokumentit: 01505446

C. nr. 125/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.F. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson E. A., avokat nga Kamenica, kundër të paditurit E.M. nga", të cilin me autorizim e përfaqëson L. C., avokat nga Kamenica, me objekt kontesti për pagimin e borxhit, vlera e kontestit prej 2.500.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqjese, më datën 08.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit J.F. nga dhe;

II. DETYROHET i padituri E.M. nga, që paditësit në emër të pagimit të borxhit t'ia paguaj shumën e të hollave prej 1.300,00 (njëmijë e treqind) euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 14.08.2019, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. Pjesa tjetër e shumës së kërkuar në lartësi prej 1.200,00 (njëmijë e dyqind) euro, në emër të pagimit të borxhit, përtej asaj të gjykuar si në pikën II të këtij dispozitivi, **REFUZOHET SI E PA BAZUAR.**

IV. DETYROHET i padituri, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 404.00 (katërqind e katër) euro, ndërsa shuma tjetër e kërkuar prej 405.00 (katërqind e pesë) euro, refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësi J.F. nga, përmes të autorizuarit të tij E.A., avokat nga Kamenica, më datën 14.08.20219, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit E.M. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson L.C., avokat nga Kamenica, për pagimin e borxhit, me vlerë të kontestit prej 2.500.00 euro.

1. Pretendimet e të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse

I autorizuari i paditësit avokati E. A., në padi, në seancën përgaditore dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë për shkak të pagimit të borxhit, duke shtuar se paditësi dhe i padituri më datën 21.06.2015, përmes marrëveshjes së shkruar private në mes tyre, janë pajtuar për pagesën e borxhit të mbetur në emër të qerasë mujore për shfrytëzimin e lokalit afarist në Kamenicë, tek qendra zejtare, dhe atë shumën e borxhit në lartësi prej 6.000,00 euro, shumë kjo për tu paguar në 3 rata (këste), të cekura si në marrëveshjen private me shkrim, tutje i autorizuari i paditësit ka shtuar se i padituri E.M., një pjesë të borxhit të paraparë me marrëveshjen me shkrim, e ka paguar dhe atë si në vijim: shumën prej 1.500.00 euro, i'a ka dorëzuar motrës së paditësit H.B., tek shtëpia e paditësit më datë 30.12.2015, rreth orës 11:30 minuta, ditë e mërkurë, shumën prej 1.000.00 euro i'a ka paguar menjëherë paditësit tek lokali i paditësit më datën 29.07.2016, në ora 14:30, ditë e premte, shumën prej 500.00 euro i'a ka paguar paditësit tek shtëpia e paditësit më datën 28.07.2017, në ora 16:15 ditë e premte, si dhe shumën e fundit prej 500.00 euro i'a ka paguar paditësit tek shtëpia e tij më datën 04.08.2015, në ora 21:00 ditë e shtune, dhe sipas kësaj i autorizuari i paditësit ka theksuar se i padituri sipas kësaj marrëveshje i ka mbetur borxh paditësit, t'ia paguaj edhe shumën prej 2.500.00 euro, për ta përmbushur borxhin në tërësi prej 6.000.00 euro të paraparë sipas marrëveshjes private me shkrim të arritur në mes palëve ndërgjygjëse, dhe sipas të njëjtit duke u bazuar edhe në dispozitat e neneve 15, 18, 22 dhe 585, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, janë plotësuar kushtet ligjore që i padituri t'ia paguaj borxhin e mbetur paditësit. I autorizuari i paditësit tutje ka theksuar se të gjitha pagesat në emër të borxhit nga i padituri ndaj paditësit janë bërë drejtpërdrejtë në dorë me para kesh, ndërsa në fjalën përfundimtare ka shtuar se pas të gjitha thënjeve të lartëcekura dhe provës së administruar materiale, si dhe faktit se i autorizuari i të paditurit nuk e ka mohur marrëveshjen me shkrim në mes palëve ndërgjygjëse për borxhin e mbetur, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe ta detyroj të paditurin që në emër të borxhit

t'ia paguaj paditësit shumën prej 2.500.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30.00 euro, si dhe në emër të përfaqësimit në 5 seanca gjyqësore për secilën nga 135.00 euro, shumën prej 675.00 euro, e në shumë të përgjithshme shumën prej 809.00 euro.

I autorizuari i të paditurit avokati L.C., në përgjigje në padi, në seancën përgaditore dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se nuk e kontestoj marrëveshjen private me shkrim të arritur në mes palëve ndërgjyqëse për borxhin e mbetur, në emër të qeras për shfrytëzimin e lokalit afarist në Kamenicë, por i njëjti ka shtuar se e konteston shumën e kërkuar në emër të borxhit të mbetur nga i padituri E.M. ndaj paditësit J. F., ngase sipas të autorizuarit të të paditurit, shuma e saktë e borxhit të mbetur është 1.300.00 euro, e jo shuma prej 2.500.00 euro të cilën e kërkon paditësi, sepse sipas të njëjtit palët kishin diskutuar për shumë e borxhit të mbetur në mes shumës 1.300.00 ose shumës 1.500.00, euro e kursesi nuk është bërë fjalë për shumën e borxhit prej 2.500.00 euro, tutje i autorizuari i të paditurit ka shtuar se paditësi me asnjë prove të vetme nuk e ka argumentuar apo provuar para gjykatës se i padituri ia ka borxh paditësit shumën prej 2.500.00 euro, madje sipas të njëjtit paditësi J. F., nuk ka paraqitur prova as për pagesat e bëra nga i padituri ndaj paditësit që të bindemi se më të vërtetë i padituri i ka mbetur borxh paditësit edhe për shumën prej 2.500.000 euro. Por, megjithëatë i autorizuari i paditësit ka theksuar se borxhi i saktë dhe i vërtetë i të paditurit ndaj paditësit është në shumë prej 1.300.00 euro, e të cilin shumë i padituri e pranon si borxh të vetin ndaj paditësit sipas marrëveshjes private me shkrim të cekur më lartë, dhe është i gatshëm ta përmbush këtë shumë prej 1.300.00 euro në emër të borxhit të mbetur, por, nuk e pranon shumën e borxhit prej 2.500.00 euro, ngase i njëjti borxh nuk është i vërtetë dhe në asnjë mënyrë nuk është vërtetuar nga paditësi me prova relevante se i padituri t'i ketë mbetur borxhë në shumë prej 2.500.00 euro, andaj, në fjalën përfundimare i autorizuari i të paditurit ka deklaruar se i padituri e kundërshton shumën e borxhit në lartësi prej 2.500.00 euro në emër të borxhit të mbetur, por, e pranon si të vetin dhe është i gatshëm ta përmbush shumën e borxhit në lartësi prej 1.300.00 euro, ngase sipas tij kjo është shuma e vërtetë e borxhit të mbetur e të paditurit ndaj paditësit, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova materiale: marrëveshjen private me shkrim, në mes të J.F. dhe E.M., që të dy nga, për pagimin e borxhit të mbetur, të datën 21.06.20215, në Kamenicë.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e proves materiale dhe të njëjtën e çmoj me kujdesë, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

Për të autorizuarit e palëve ndërgjyqjese nuk ishte kontestues fakti se palët ndërgjyqjese kishin arritur marrëveshje private me shkrim për pagimin e borxhit të mbetur nga ana e të paditurit ndaj paditësit, por, kontestuese për të autorizuarin e të paditurit ishte shuma e borxhit të kërkuar si borxh i mbetur, respektivisht i autorizuari i të paditurit nuk e pranon shumën e borxhit prej 2.500.00 euro të kërkuar nga paditësi, ngase sipas tij shuma reale e mbetur e borxhit nga i padituri ndaj paditësit është 1.300.00 euro.

Në bazë të marrëveshjes private me shkrim, në mes të J.F. dhe E.M., që të dy nga për pagimin e borxhit të mbetur, të datën 21.06.20215, në Kamenicë, gjykata e vërtetoi faktin se palët ndërgjyqjese kishin arritur marrëveshje që në emër të borxhit të mbetur për shfrytëzimin e lokalit afarit në qendrën zejtare në Kamenicë, i padituri E.M., t'ia paguaj paditësit J.F. shumën prej 6.000 euro, dhe atë në tri rata – këste të përshkruara si në marrëveshjen private me shkrim.

3. Baza juridike

Duke u bazuar në të lartcekurat, si dhe në dispozitat e nenit 7 dhe 8, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), ku përcaktohet se *“palët kontraktuese në marrëdhënie detyrimore kontraktuese janë të detyruara ti kryejnë detyrimet e ndërsjella dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke”*, gjykata ka vlerësuar se ekziston detyrimi i të paditurit për pagesën e borxhit në shumën e gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, prej 1.300.00 euro, ndaj paditësit. Pra, i padituri duke mos e kryer detyrimin e tij në tërësi, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e borxhit në emër të qerasë për shfrytëzimin e lokalit afarist edhe për shumën prej 1.300.00 euro, e të cilën shumë si borxh të mbetur e ka pranuar edhe vet i autorizuari i të paditurit, duke pohuar se i padituri do ta përmbush këtë shumë të borxhit. Andaj, ndërmjet palëve ndërgjyqjese është krijuar raporti detyrimorë në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa i padituri cilësinë e debitorit.

E duke u bazuar edhe në dispozitën e nenit 245, të LMD-së, ku përcaktohet se *“kreditoret në marrëdhëniet detyimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojnë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi”*, gjykata duke u nisur nga fakti se i padituri me mospagimin e borxhit të mbetur në emër të qerasë i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartëcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurin që paditësit t’ia paguj - përmbush borxhin në shumën e gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa duke u bazuar në dispozitën e nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, si dhe në dispozitën e nenit 319, të po këtij ligji, ku përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjygjëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, e duke u nisur nga fakti se paditësi me asnjë provë materiale nuk ka arritur që ta provoj se i padituri i ka borxh të njëjtit shumën prej 2.500.00 euro, aq sa i ka kërkuar, në emër të qirasë së pa paguar, gjykata e ka aprovuar si shumë të borxhit vetëm shumë në lartësi prej 1.300.00 euro, aq sa i autorizuari i të paditurit e ka pohur – pranuar si borxh të të paditurit ndaj paditësit, ndërsa në mungesë të provave materiale dhe atyre personale, e ka refuzuar shumën tjetër të kërkuar përtej asaj të gjykuar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit J.F. është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtuqë e ka detyruar të paditurin E.M. nga, që paditësit J.F. nga, në emër të qeras për shfrytëzimin e lokalit afarist në qendrën zejtare, në, t’ia paguaj shumën e borxhit të mbetur prej 1.300.00 euro, ngase gjykata përmes marrëveshjes private me shkrim, në mes të J.F. dhe E.M., që të dy nga, për pagimin e borxhit të mbetur, të datën 21.06.20215, në, e ka vërtetuar faktin se palët ndërgjygjëse kishin arritur marrëveshje që në emër të borxhit të mbetur për shfrytëzimin e lokalit afarit në qendrën zejtare në, i padituri E.M., t’ia paguaj paditësit J.F. shumën prej 6.000.00 euro, dhe atë në tri rata – këste të përshkuara si në marrëveshjen private me shkrim, e në bazë të kësaj marrëveshje gjykata e ka vërtetuar faktin se i padituri E.M., i kishte mbetur borxh në emër të qirasë për shfrytëzimin e lokalit afarist

paditësit J.F., por, që paditësi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme materiale apo personale për ta provuar para gjykatës shumën e kërkuar të borxhit të mbetur prej 2.500.00 euro, aq sa e ka kërkuar, ngase i autorizuari i paditësit vetëm përmes deklarimeve të tij verbale e ka elaboruar pjesën e borxhit të cilin e kishte kryer sipas të njëjtit i padituri ndaj paditësit dhe shumën e borxhit të cilën sipas të njëjtit kishte mbetur i padituri pa e përmbushur, por, nuk ka ofruar asnjë provë materiale për ta vërtetuar saktësisht shumën e borxhit të mbetur pa e paguar i padituri ndaj paditësit, ndërsa në anën tjetër i autorizuari i të paditurit, e ka pohuar respektivisht e ka pranuar si borxh të të paditurit E.M. ndaj paditësit J.F., shumën prej 1.300.00 euro dhe ka shprehur vullnetin që i padituri do ta paguj këtë shumë të borxhit ndaj paditësit. Andaj, duke e pasur parasysh faktin që i autorizuari i paditësit nuk ka arritur që para gjykatës ta argumentoj, respektivisht ta provoj përmes ndonjë prove materiale dhe relevante, shumën e saktë të borxhit të të paditurit ndaj paditësit, si dhe duke e marrë për bazë faktin se i autorizuari i të paditurit e ka pohuar respektivisht e ka pranuar si borxh të të paditurit ndaj paditësit, shumën prej 1.300.00 euro, gjykata e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar në ligj kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurin E.M. t'ia paguaj shumën prej 1.300.00 euro në emër të borxhit të pa paguar paditësit J.F., duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës së kërkesëpadisë edhe për shumën prej 1.200.00 euro, të kërkuar në emër të borxhit të mbetur, gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar, ngase paditësi nuk ka arritur me asnjë provë relevante ta bindë gjykatën se i padituri i'a ka borxh edhe këtë shumë të parave në emër të qerasë së pa paguar, dhe në mungesë të provave gjykata këtë pjesë të kërkesëpadisë të paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar në ligj dhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në lartësinë e aprovuar për pagimin e borxhit, paditësit i'a ka njohur të drejtën e kamatës ligjore prej 8%, nga data 14.08.2019, si datë e paraqitjes së paditës e deri në pagesën definitive, dhe atë në bazë të nenit 382, të LMD-së.

5. *Shpenzimet e procedurës kontestimore*

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452, paragrafi 2, të LPK-së, dhe e detyrojë të paditurin, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 404.00 (katërqind e katër) euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumën prej 30.00 euro dhe në emër të përfaqësimit në 2 (dy) seanca gjyqësore në atë

përgaditore dhe në atë të shqyrtimit kryesor shumë prej 270.00 euro, ndërsa shumën tjetër të kërkuar prej 405.00 (katërqind e pesë) euro, e refuzoj si të pa bazuar, ngase duke e pasur parsasysh suksesin e paditësit në procedurën gjyqësore, i cili e ka fitur kontestin vetëm pjesërisht, gjykata vendosi që edhe shpenzimet e procedurës t’ia njeh të njëjtit pjesërisht duke i njohur vetëm ato shpenzime të domosdoshme dhe në përputhje me suksesin e arritu në procedurën gjyqësore lidhur më këtë çështje juridike kontestimore.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe në dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C. nr. 125/2019, i datës 08.02.2021

G j y q t a r i

Artan Abazi

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.